

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 6, datë 17.7.2026

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË
ARDHURAVE DYTËSORE QË KRIJOHEN NGA PAGESA E SUBJEKTEVE TË
INTERESUARA PËR PROMOVIMIN E AKTIVITETEVE DHE PËR SHËRBIMET
TURISTIKE NË HAPËSIRAT E MENAXHUARA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E
TURIZMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 15, të nenit 14, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Ky udhëzim ka për objekt miratimin e procedurës për mbledhjen dhe përdorimin e të ardhurave dytësore që krijohen nga pagesa e subjekteve të interesuara për promovimin e aktiviteteve dhe për shërbimet turistike në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe përdorimit të drejtë të tyre.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “**AKT**” është Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- b) “**Subjekte të interesuara**” janë subjektet publike ose private që përfitojnë shërbime promovuese ose informuese nga Agjencia Kombëtare e Turizmit kundrejt pagesës;
- c) “**Të ardhura dytësore**” janë të ardhurat që krijohen nga ofrimi kundrejt pagesës i shërbimeve promovuese dhe informuese, si dhe nga përdorimi i hapësirave, mjeteve dhe platformave në administrim të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

3. Agjencia Kombëtare e Turizmit ofron kundrejt pagesës shërbime promovuese dhe informuese, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shërbime promionale digjitale përmes faqeve zyrtare, aplikacioneve dhe platformave elektronike;
- b) shërbime promovuese në panairë, evente, konferenca dhe veprimtari të tjera kombëtare ose ndërkombëtare;
- c) shpërndarjen e materialeve promovuese dhe informuese në formë të shtypur ose elektronike;
- ç) forma të tjera shërbimesh që lidhen drejtpërdrejt me funksionet ligjore të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

4. Ofrimi i shërbimeve promovuese nga Agjencia Kombëtare e Turizmit realizohet në përputhje me funksionet e saj ligjore, mbi bazën e parimeve të eficiencës, transparencës dhe mbulimit të kostos, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pagesat për shërbimet e ofruara kryhen nëpërmjet faturimit elektronik ose formave të tjera të arkëtimit, në përputhje me legjislacionin financiar dhe tatimor në fuqi.

6. Të ardhurat dytësore administrohen nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, në përputhje me rregullat e administrimit financiar publik dhe legjislacionin buxhetor në fuqi.

7. Të ardhurat dytësore ndahen ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe buxhetit të shtetit, si më poshtë:

- a) 90 % e të ardhurave mbeten në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

b) 10 % e të ardhurave derdhen në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin financiar dhe buxhetor në fuqi.

8. Pjesa e të ardhurave që mbetet në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Turizmit përdoret, brenda limiteve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, vetëm për:

- a) zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe platformave promovuese;
- b) realizimin e aktiviteteve të promovimit kombëtar dhe ndërkombëtar të turizmit;
- c) mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve ligjore të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

9. Përdorimi i të ardhurave dytësore kryhet brenda limiteve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit.

10. Agjencia Kombëtare e Turizmit siguron transparencë përmes publikimit të tarifave, shërbimeve dhe informacionit mbi përdorimin e të ardhurave në faqen e saj zyrtare.

11. Agjencia Kombëtare e Turizmit raporton pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, mbi nivelin e të ardhurave dytësore të mbledhura dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

12. Raportimi mbi të ardhurat dytësore dhe përdorimi i tyre kryhet mbi bazë mujore, në përputhje me procedurat e administrimit financiar publik dhe detyrimin për rakordimin periodik të të ardhurave dhe shpenzimeve me degën e thesarit.

13. Raporti përfshin të dhëna të detajuara mbi burimet e të ardhurave, nivelin e arkëtimeve, si dhe shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin financiar dhe buxhetor në fuqi.

14. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj